



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Integrimin European

PROCESVERBAL

Tiranë, më 17.09.2019, ora 12:15

Drejton mbledhjen:

Rudina Hajdari – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 09.09.2019.
2. Seancë dëgjimore me ministrin në detyrë për Europën dhe Punët e Jashtme, zotin Gent Cakaj, lidhur me rekomandimet e raportit të Komisionit për Integrimin European dhe planin e veprimit për zbatimin e tyre.
3. Shqyrtimi i projektligjit “Për ndryshimet klimatike”.
4. Çështje të tjera.

Marrin pjesë:

Rudina Hajdari, Senida Mesi, Taulant Balla, Musa Ulqini, Mirela Kumbaro, Arben Kamami, Klodiana Spahiu, Ralf Gjoni, Andrea Marto, Nikolin Staka, Edlira Hyseni dhe Kostaq Papa.

Mungojnë:

Fatmir Velaj, Ilir Pendavinji dhe Sadri Abazi.

Të ftuar:

Gent Cakaj – Ministër në detyrë për Europën dhe Punët e Jashtme

Admira Jorgji – Drejtoreshë e Drejtorisë së Bashkimit European në Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme

Fiona Demneri – Këshilltare për Mediat në Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme

Altin Fuga – Përgjegjës Sektori në Drejtorinë e Bashkimit European në Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme

Ornela Çuçi – Zëvendësministre e Turizmit dhe Mjedisit

Athanas Karaja – Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë Rregullatore dhe Përputhshmërisë në Turizëm dhe Mjedis në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit

Klodiana Marika – Drejtoreshë e Programeve të Zhvillimit të Mjedisit në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit

Vilma Kola – Drejtoreshë e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Mjedisit në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit

Eneida Rabdishta – Specialiste në Drejtorinë e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Mjedisit në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit

HAPET MBLEDHJA

Rudina Hajdari – Mirëdita të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e sotme të Komisionit të Integritetit Europian.

Si pikë të parë të rendit të ditës kemi miratimin e procesverbalit të mbledhjes së kaluar, të cilin e keni përpara në tavolinë. Kush ka vërejtje nga kolegët, tani është momenti për t'u shprehur. Nëse jo, e quajmë të miratuar dhe vijojmë me pikën e dytë të rendit të ditës: seancë dëgjimore me ministrin në detyrë për Europën dhe Punët e Jashtme, zotin Gent Cakaj.

Do t'ia japim fillimisht fjalën ministrit në detyrë, zotit Cakaj, për të vijuar më pas me pyetje dhe diskutime nga kolegët e komisionit.

Zoti Ministër, ndjesë për vonesën, por sot kemi pasur shumë komisione!

Tematika, për të cilën jeni ftuar, merr një vëmendje të gjerë për momentin, duke pasur parasysh se na ndan vetëm një muaj nga vendimi i Këshillit të Bashkimit Europian për çeljen e negociatave me Shqipërinë, ndaj me dakordësinë tuaj, uroj të keni kohë në dispozicion që t'u përgjigjeni të gjitha pyetjeve që mund të kenë sot anëtarët e Komisionit të Integritetit Europian.

Edhe një herë, ka vërejtje nga kolegët për procesverbalin e mbledhjes së kaluar? Nuk ka.

Miratohet procesverbali.

Fjala është për ju, zoti Ministër.

Gent Cakaj – Faleminderit, zonja kryetare, për ftesën dhe për mundësinë që të diskutojmë hapur dhe në mënyrë përmbajtësore për zhvillimet e përgjithshme në axhendën e integritetit europian!

Natyrisht, nëse do të keni pyetje shtesë ose do të ketë hapësirë për sqarime të nevojshme, unë mbetem në dispozicionin tuaj për çdo gjë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po ofroj një pasqyrë të përgjithshme të zhvillimeve që vijnë si rrjedhojë e vendimit të Këshillit në qershor të vitit 2018.

Natyrisht, një element i rëndësishëm teknik për t'u nënvizuar është autorizimi që Këshilli i ka dhënë Komisionit për të filluar procesin përgatitor për hapjen e negociatave me Shqipërinë. Si rezultat, ne kemi filluar praktikisht procesin *screening* apo procesin e studimit të legjislacionit vendas, krahasuar me atë europian, dhe deri tani janë mbajtur 25 takime në Bruksel, ku është studiuar hollësisht legjislacioni europian, që është një prej elementeve

kryesore teknike të vetë procesit të negocimit. Nga kjo pikëpamje dua të theksoj tre faktorë të rëndësishëm.

Së pari, ky proces ka kontribuar në konsolidimin organizativ të grupeve përgjegjëse të punës për secilin kapitull.

Së dyti, i ka kursyer kohë të madhe Shqipërisë, meqenëse, edhe nëse negociatat do të hapen në muajin tetor, praktikisht, ne do të jemi në stadin e zhvillimit të procesit të negociatave sikurse negociatat të ishin hapur vitin e kaluar. Në fund ka pasur një implikim politik, çka vetëm sa e ka vendosur Shqipërinë në binarët e procesit të zhvillimit të një ndërmarrjeje që, natyrisht, u takon vetëm shteteve që aktualisht negociojnë për anëtarësim.

Faktori i dytë që dua të nënvizoj, natyrisht, është plotësimi i kushteve të nevojshme për hapjen e negociatave. Nëse më lejoni, këtu dua të bëj një shtjellim disi më politik. Publikimi i raportit të Komisionit European në maj të këtij viti nuk ka qenë thjesht një publikim i zakonshëm i progresraportit të çdo viti tjetër, për shkak se në paragrafin 54 të konkluzioneve të 26 qershorit të vitit 2018 të Këshillit për Çështjet e Përgjithshme, Këshilli kërkon specifikisht nga Komisioni të bëjë verifikimin e kushteve shtesë, që i janë vendosur Shqipërisë për hapjen e negociatave.

Në qershorin e vitit të kaluar Këshilli ka vendosur që t'u përgjigjet pozitivisht reformave që ka ndërmarrë Shqipëria dhe arritjeve kryesore të saj, duke hapur mundësinë për çeljen e negociatave këtë vit. Sidoqoftë, ka kërkuar performancën e shtuar të Shqipërisë në tre faktorë kyçë: në vazhdimin e procesit të vetingut, në ngritjen e institucioneve të reja të drejtësisë, me theks të veçantë ngritjen e SPAK-ut dhe Byrosë Kombëtare të Hetimit, ndërkohë që kërkesa e tretë ka qenë shtimi i rezultateve në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Por natyrshëm shtrohet pyetja: cila është njësia matëse e performancës së Shqipërisë për këto tri kushte të kërkuara? Përgjigjen e ka dhënë ndoshta vetë Këshilli i Çështjeve të Përgjithshme vitin e kaluar, për shkak se e ka autorizuar Komisionin European të japë përgjigje specifikisht për përmbushjen e kushteve në fjalë. Kësisoj, Komisioni ka thënë fjalën e tij, duke ofruar dëshmi dhe vlerësimin pozitiv se të gjitha kushtet teknike të parashtruara për Shqipërinë janë plotësuar, për rrjedhojë Shqipëria meriton hapjen e negociatave.

Duhet nënvizuar që në qershor të këtij viti ka ardhur një vendim tjetër për shtyrjen e vendimit të negociatave, por kjo nuk ka qenë vetëm shtyrje e negociatave në kohë, nuk ka qenë vetëm një zhvendosje mekanike e vendimmarrjes, le të themi, për shkak se në ato vlerësime, Këshilli, në mënyrë afirmative, miraton dhe pranon rekomandimet dhe vlerësimet

e Komisionit, gjë që e vendos Shqipërinë në një avantazh të konsiderueshëm për shkak se paraprakisht Këshilli ka shfaqur disponimin për t'i trajtuar pozitivisht rekomandimet e Komisionit, që sugjerojnë hapjen e negociatave për anëtarësim.

Për sa u përket këtyre tri kushteve, nuk dua të bëj interpretim personal nëse janë plotësuar ose jo, për shkak se të dhënat gjenden në raportin e Komisionit, i cili vlerëson specifikisht faktin se 88 gjyqtarë dhe prokurorë janë larguar prej detyrës si rrjedhojë e procesit të vetingut, gjë që tregon se në procesin e vetingut, përveçse nuk ka pasur cedime ose ngecje, ka pasur një bashkëpunim të konsiderueshëm me Operacionin Ndërkombëtar të Monitorimit.

Faktori i dytë është ngritja e trupave të reja në sistemin e drejtësisë, gjë për të cilën Komisioni vlerëson zhvillimet e dhjetorit të vitit 2018, përkatësisht ngritjen e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe Këshillit të Emërimeve në Drejtësisë, që kanë hapur shtegun për ngritjen e SPAK-ut dhe të Byrosë Kombëtare të Hetimit brenda afateve të parashikuara ligjore. Rezultatet teknike, unë nuk po e jap secilën të dhënë, janë të paraqitura në progresraport.

Për sa i përket luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, thuhet se Shqipëria ka bërë progres të mjaftueshëm për të merituar hapjen e negociatave. Nga kuadri i meritave dhe rezultateve të Shqipërisë, përgjigjja është e qartë se qoftë nga kapaciteti administrativ dhe institucional, për shkak të procesit *screening*, që ne kemi filluar nga shtatori i vitit të kaluar, qoftë nga kushtet që janë përmbushur ndërkohë, mund të thuhet se Shqipëria është e gatshme të fillojë procesin e negocimit në momentin kur Këshilli të vendosë pozitivisht për hapjen e negociatave.

Po ashtu, dua të nënvizoj edhe një element tjetër. Ne kemi qenë aktivë edhe në një fushatë diplomatike, meqenëse vitin e kaluar ne kemi marrë një mësim elementar, që ndoshta e kemi mësuar nga përvoja jonë, por është një mësim që e kanë kaluar edhe shtetet para Shqipërisë: ekziston një mospërputhje ndërmjet rekomandimeve teknike të Komisionit dhe vlerësimit politik të Këshillit. Vitin e kaluar, në një masë të madhe, vendimi i Këshillit ka qenë i diktuar nga klima elektorale që ka mbizotëruar për shkak të zgjedhjeve europiane, që kanë qenë në horizont, duke sjellë kështu pamundësinë për t'iu përgjigjur pozitivisht rekomandimeve të Komisionit. Ndërkohë, këtë vit është esenciale që Shqipëria të angazhohet me të gjithë arsenalin e saj politik dhe diplomatik për të bërë të mundur që rekomandimet teknike të Këshillit të shndërrohen në vullnet politik të Komisionit.

Kemi zhvilluar një gamë të gjerë takimesh dypalëshe, po ashtu kemi pasur një pjesëmarrje aktive në forumet multilaterale për t'u dhënë rast vendeve anëtare që të mësojnë në mënyrë më përmbajtësore dhe më kompetente për të gjitha zhvillimet në Shqipëri, duke hedhur më tepër dritë në shkallën e progresit që ka shënuar Shqipëria dhe, natyrisht, të shtjellojmë rëndësinë rajonale, gjeostrategjike dhe politike, më përgjithësisht të një vendimmarrjeje pozitive për hapjen e negociatave në tetor të këtij viti.

Kjo përmbledh, pak a shumë, kuadrin e aktiviteteve të qeverisë shqiptare dhe jo vetëm. Ky është një proces ku ka luajtur rol edhe Kuvendi dhe institucionet e tjera, po ashtu është një pasqyrë e përgjithshme se ku jemi aktualisht në procesin e integritit europian.

Për të mos e monopolizuar këtë diskutim dhe për të mos mbajtur një ligjëratë të gjatë lidhur me progresin e Shqipërisë në rrugën europiane, e ofroj veten time në dispozicionin tuaj për t'iu përgjigjur çdo pyetjeje që do të përbënte interes për ju.

Faleminderit!

Rudina Hajdari – Faleminderit, zoti Cakaj!

Kalojmë në pyetje e diskutime.

Kam dëshirë ta filloj me disa pyetje që kanë të bëjnë pikërisht me ato që thatë ju, por edhe me disa gjera shtesë që kemi pasur si ankesa, në fakt, si Komisioni i Integritit Europian.

Kam për ju gati katër pyetje, nëse është e mundur, dhe nuk e di si dëshironi të procedojmë: t'ju parashtroj të gjitha pyetjet dhe pastaj ju të përgjigjeni, apo një nga një?

Gent Cakaj – Si të jetë më e përshtatshme për ju. Ndoshta unë mbaj shënim pyetjet dhe përgjigjem për të gjitha në fund.

Rudina Hajdari – Dakord.

E para, Komisioni i Integritit Europian ka dërguar disa shkresa që prej publikimit të raportit të Komisionit Europian. Si praktikë parlamentare, ne duhet ta kemi në dispozicion planin e veprimit që Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme bën pas raportimit të Komisionit Europian. Kemi dërguar disa *email*-e nëpërmjet sekretariatit më 31 korrik, pastaj kemi dërguar disa kërkesa të tjera për t'ju pasur këtu në seancë dëgjimore.

Ju kujtoj se Komisioni për Integritimin Europian është një organ tejet i rëndësishëm parlamentar, i cili mbikëqyr dhe kontrollon veprimet e qeverisë. Flas këtu për një respektim të shtyllave kryesore të demokracisë, pra ndarjen e pushteteve.

Duke pasur parasysh rolin tonë dhe faktin që ne duhet të jemi sa më produktivë në planin e veprimit që na jepet nga Komisioni Europian për të plotësuar prioritetet, kam një pyetje: pse nuk është respektuar ligji dhe institucioni i Kuvendit, sipas jush, zoti Cakaj?

Pyetja e dytë ka të bëjë me takimet që ju keni bërë në vendet e Bashkimit European. Theksoj këtu faktin se ne, gjithashtu, kemi zhvilluar takime me vendet e BE-së dhe kemi hasur shumë problematika me vendet anëtare, të cilat janë skeptike, si Holanda, Gjermania, Franca, Danimarka, si dhe kohët e fundit, Greqia. Theksoj këtu që ndoshta Gjermania nuk ka qenë aq skeptike, por ka qenë shumë e qartë për kushtet që i ka vënë Shqipërisë.

Këto vende kanë shprehur shqetësimin e tyre dhe vazhdojnë ta bëjnë ende, prandaj edhe ne kemi shqetësimin për vendimin që do të merret në samitin e ardhshëm në Këshillin European.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në lidhje me këtë çështje.

Zoti Ministër, a jeni i informuar se cili është niveli i zbatimit, i *track records*, siç e quajmë ata, sidomos kur flitet për luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar? Cili është një nivel i kënaqshëm për këto vende skeptike dhe sa është zbatuar kjo kërkesë nga ana e qeverisë, në mënyrë që këto vende të mos hezitojnë në vendimin e tetorit, që do të jepet bashkërisht për Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut, në mënyrë që ne të mos kemi pasojën e rëndë të ndarjes, të vendimit ndërmjet Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut?

Pyetja e tretë. Zoti Ministër, ju keni zhvilluar një takim bashkërisht me Kryeministrin e Shqipërisë në Gjermani kohët e fundit, me kancelaren Merkel, një takim patjetër shumë i rëndësishëm. Komisioni i Integritetit European ka interes të dijë se çfarë u fol në këtë takim.

Për sa i përket reformës në drejtësi, a ishin të kënaqshëm, duke marrë parasysh se organet e reformës në drejtësi nuk janë ngritur ende? Kur parashikohet ngritja e këtyre organeve?

Po ashtu, Bundestagu dhe kancelarja Merkel, sidomos skeptikët brenda partive të ndryshme në Bundestag, kanë shprehur skepticizmin e tyre për sa i përket pastërtisë së figurave politike në Shqipëri. Ju lutem, çfarë masash do të merren për ndëshkimin e këtyre figurave që janë lakuar, po themi, si persona problematikë? Në fakt, kanë kërkuar të luftojmë ashpër politikanët e korruptuar në nivele të larta. A do të kemi rezultate në këtë kuadër?

Pyetja e fundit, nëse më lejon, lidhet me reformën zgjedhore. Ju vetë jeni shprehur në një deklaratë për shtyp kohët e fundit se reforma zgjedhore do të diskutohet dhe do të përfshijë të gjitha forcat politike dhe ato jashtëparlamentare. Në gjykimin tuaj, a mendoni se kjo reformë do të ndjekë të gjitha rrugët institucionale, pra në respektim të Kushtetutës dhe institucioneve shqiptare, pa i anashkaluar këto institucione? A mendoni se kjo reformë, e cila përflitet se do të jetë, po ashtu, një kusht kryesor për Shqipërinë, pas asaj të reformës në

drejtësi, duhet të ndodhë jashtë kuadrit institucional? Nëse jo, cili është mendimi juaj në lidhje me reformën zgjedhore?

Kjo ishte gjithçka që unë doja të pasqyroja.

Fjala është për ju, zoti Ministër.

Gent Cakaj – Shumë faleminderit!

Ishin katër pyetje, por, në fakt, me shumë nënpyetje përbrenda.

Lidhur me vonesën e dërgimit të planit afatshkurtër të masave për përmbushjen e rekomandimeve të Komisionit, dua të sqaroj se nuk është as mungesë bashkëpunimi ndërmjet qeverisë dhe Kuvendit, as mungesë respekti, siç thatë ju, ndaj këtij komisioni apo parlamentit në përgjithësi.

Ka diçka që unë krejt sinqerisht dua ta ndaj me ju dhe në mënyrë krejt të hapur. Afati i përcaktuar prej ligjit aktual është tri javë, brenda të cilit Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme detyrohet të dërgojë raportin e planit të masave. Sidoqoftë, ky ligj është miratuar në një kohë kur komisioni ka pasur një praktikë tjetër në publikimin e progresraportit. Në atë kohë raportet janë publikuar në vjeshtë, në fund të vitit dhe, për rrjedhojë, ka pasur kohë të mjaftueshme për përfshirjen e të gjitha masave në planin e integritetit europian për vitin vijues dhe, po ashtu, ka qenë i mundur planifikimi edhe në parametrat e rinj buxhetorë të masave të reja, që duhet të reflektoheshin në planin përkatës.

Tani që raporti publikohet në mes të vitit faktikisht, sepse kësaj here është publikuar në maj, ka qenë tepër e vështirë dhe tejet sfiduese që plani të zbërthehet në masa konkrete, të cilat do të jenë në përputhje, kompatible me PKIE-në, planifikimet buxhetore dhe, po ashtu, ka kërkuar një gjykim më të hollësishëm teknik se cilat prej masave duhet të mbarten vitin e ardhshëm, për shkak se ky, ndonëse quhet plani i masave afatshkurtra, në rekomandimet e Komisionit ka shumëçka që nuk mund të cilësohen thjesht masa afatshkurtra. Bie fjala, ngritja e institucioneve të reja të drejtësisë është proces njëvjeçar, shumëvjeçar, dhe nuk mund të reduktohet në masa afatshkurtra, aq më tepër është shumë problematike të diskutohet për afate kohore të prera se kur do të zbatohet.

Kësisoj, procesi teknik i përgatitjes së planit të masave kësaj here ka qenë më i vështirë për shkaqe rrethanore. Por kjo nuk do të thotë se nuk ka mundur të bëhet një plan dosido për tri javë, por Shqipëria nuk është në fazën ku mund të përballojë një plan dosido për integrimin europian. Ky nuk është thjesht arsyetim para jush, por ka edhe një arsye tjetër për këtë. Shumica e masave të reja, që janë paraqitur në rekomandimet e Komisionit këtë vit, janë rekomandime të cilat vijnë dhe janë zgjatim i rekomandimeve të raportit të Komisionit të

vitit të kaluar. Kësisoj, vonesa në dorëzimin e raportit nuk manifestohet edhe në pengesa dhe vonesa në zbatim të rekomandimeve të Komisionit, meqenëse për shumicën e rekomandimeve që, veçse do të jenë të pranishme në këtë raport, ekziston edhe një punë aktive operacionale në zbatim të tyre, si rrjedhojë e obligimeve që kemi marrë nga plani i masave të vitit të kaluar.

Teknikisht ne e kemi dorëzuar sot draftin e raportit dhe jemi në fazën ku edhe raporti, edhe plani i masave do të diskutohen dhe do të miratohen në Këshillin e Ministrave. Kjo është për sa i përket përgjigjes së parë. Natyrisht, nëse mendoni se duhet të ofroj përgjigje shtesë, unë jam i gatshëm.

Elementi i dytë është marrëdhënia politike me vendet skeptike dhe adresimi i shqetësimeve të tyre. Ndonëse ju përmendet 5 shtete, të cilat kanë qëndrime skeptike, përkatësisht: Gjermaninë, Danimarkën, Greqinë, Holandën dhe Francën, ky ishte vlerësim juaj, sepse unë nga komunikimet me homologët e vendeve përkatëse mund të kem përshtypje të tjera, por pavarësisht që ju i kualifikuat në një grup të konsoliduar politik dhe i kualifikuat si vende skeptike, problemi është se të gjitha këto vende kanë specifikat e tyre dhe burimet e shqetësimeve të tyre nuk lidhen asnjëherë drejtpërdrejt me të njëjtat çështje. Nëse në një vend mund të jetë shqetësim shkalla e kriminalitetit në Shqipëri, në një vend tjetër prevalojnë dilemat nëse duhet të ketë vendime për zgjerimin para se të ketë një reformë të brendshme të Bashkimit Europian. Natyrisht, qasja jonë ka qenë që, varësisht prej shteteve përkatëse, të kemi edhe një plan komunikimi sipas veçorive të secilit vend.

Specifikisht, ndërsa adresuat pyetjen tuaj, ju përmendet edhe shqetësimin lidhur me krimin e organizuar në Shqipëri. Lidhur me këtë dua të sqaroj se, së pari, ky është një diskutim dhe fushatë për hapjen e negociatave dhe nuk është një fushatë për negocimin për mbylljen e kapitullit 23 ose 24 dhe as për marrjen e anëtarësimit nesër. Natyrisht që Shqipëria është një vend me shumë probleme, por nuk është ky thelbi i çështjes, pasi thelbi i çështjes është nëse Shqipëria ka akumuluar një masë kritike reformash, të cilat mundësojnë çeljen e negociatave. Krahësuar me praktikën e hapjes së negociatave për vendet në rajon Shqipëria ka bërë më shumë se çdo vend tjetër në rajon për ta merituar këtë proces.

Ne jemi në situatën kur jemi duke kryer vetingun jo si pjesë e procesit negociator, por si një ndërmarrje paraprake për të merituar procesin negociator. Në këtë pikëpamje meritat e Shqipërisë nuk vihen në pikëpyetje dhe duhet të vlerësohen, gjithmonë në raport me shkallën ku Shqipëria qëndron në axhendën e saj europiane.

Së fundi, shkalla e krimit të organizuar mund të vlerësohet ndryshe nga një vend tjetër, ndryshe nga ne, ndryshe nga një parti opozitare në Shqipëri dhe ndryshe nga një institucion tjetër i Bashkimit European. Unë dua të jem i përgjegjshëm para jush, sepse dua të jem një *man* llogaridhënës para jush dhe nuk dua të bëj lëvdata për punën e qeverisë dhe as nuk do të bie në kurthin e aktorëve të tjerë, që, për shkak të raporteve të diskutueshme që kanë me procesin e negociatave, akuzojnë për krimin e organizuar dhe korrupsionin. Për shkallën e krimit të organizuar në Shqipëri, përkatësisht për nivelin e luftimit të krimit të organizuar dhe korrupsionit, Komisioni European ka dhënë një përgjigje. Kjo nuk është thjesht se unë ose qeveria kërkojmë mburojë prapa vlerësimeve teknike të Komisionit European, por në paragrafin nr. 54 të konkluzioneve të Këshillit të Çështjeve të Përgjithshme të qershorit të vitit 2018 Këshilli konsideron se vlerësimi i komisionit do të jetë njësi matëse kryesore nëse Shqipëria ka bërë progresin e duhur në këtë drejtim, pasi ekziston një nevojë për të vendosur një standard të padiskutueshëm, mbi të cilin do të bëhet vlerësimi, sepse ne mund të flasim për luftë masive kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, por prapë do të ketë një dilemë nëse është zhbërë në tërësi. Për të merituar hapjen e negociatave, përgjigja është dhënë mbi një referencë standarde, jo thjesht se kjo është rutina e punës së institucioneve të Bashkimit European, por sepse edhe Këshilli i Çështjeve të Përgjithshme e ka konsideruar atë si njësi matëse për vendimin e radhës së vitit 2019.

Lidhur me takimin me kancelaren gjermane dhe vizitën e fundit në Gjermani, unë jam në një pozicion të vështirë, meqenëse qëndroj midis dy poleve problematike politike, ku nga njëra anë dua të jem maksimalisht llogaridhënës në raport me ju dhe nga ana tjetër jam i detyruar të ruaj fshehtësinë e bisedave të takimeve në fjalë. Sidoqoftë, unë mund të komunikoj me ju mesazhet kryesore nga takimi. E vërteta është, kjo është komunikuar gjithmonë nga qeveria gjermane dhe është komunikuar edhe në konferencën për media, që unë kam zhvilluar me ministrin e Jashtëm të Gjermanisë, pozicioni i qeverisë ka qenë i qartë, që vendimi për hapjen e negociatave duhet të jetë i padiskutueshëm, qoftë për meritat e Shqipërisë, qoftë për shkak të ndikimit të tij të patjetërsueshëm gjeostrategjik. Sidoqoftë, sfida dhe veçoria e Gjermanisë qëndron te fakti se autorizim i ministrit përgjegjës për Europën në qeverinë gjermane për të votuar pro ose kundër hapjes së negociatave në zhvillimin e çështjeve të përgjithshme fillimisht vjen drejtpërdrejt nga Bundestagu. Në Gjermani nuk duhet të ketë vetëm një intensifikim të kontakteve dhe një fushatë diplomatike me ekzekutivin, por duhet të shtrihet edhe në nivel deputetësh dhe institucioneve të tjera parlamentare. Ajo që është e rëndësishme të nënvizohet është se ka një përmirësim të

dukshëm të klimës politike atje, e cila është vënë re edhe në takimin me kancelaren, por edhe në listën e takimeve të tjera që kemi zhvilluar në Gjermani. Lidhur me këtë unë po adresoj edhe pyetjen tuaj të fundit për reformën zgjedhore, pasi nënpyetja juaj, tek takimi me kancelaren Merkel, ishte edhe çështja e ngritjes së organeve të reja të drejtësisë dhe kur e shoh unë ngritjen e tyre. Në fakt, ky nuk është një vendim që më përket mua dhe unë nuk kam kapacitetin të ofroj këtu një parashikim kohor se kur do të ngrihen institucionet e drejtësisë, ngaqë thelbi i reformës në drejtësi ka qenë pavarësia absolute e gjyqësorit. Nga pozicioni i ekzekutivit, unë nuk mund të flas për zhvillimet në gjyqësor. Unë mund të komunikoj ato jashtë, bazuar në raportet objektive që ekzistojnë, në mënyrë që ta përmirësoj narrativën e Shqipërisë në Europë, por unë nuk mund të jap parashikime të brendshme për ngritjen dhe funksionimin e plotë të organeve të reja të drejtësisë. Sidoqoftë, ajo që unë dua të theksoj është se në konkluzionet e Këshillit të Çështjeve të Përgjithshme të vitit të kaluar nuk ekziston një kusht, sepse në opinion interpretohet shpeshherë kështu që SPAK-u dhe Byroja Kombëtare e Hetimeve duhet të jenë tërësisht funksionale me një numër të konsiderueshëm të hetimeve para se të fillojë procesi i hapjes së negociatave. Në fakt, kushti ka qenë finalizimi i procedurave për vendosjen e SPAK-ut dhe Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe ky proces është duke u zhvilluar në përputhje me parametrat kohorë të parashikuar në kornizën e reformës në drejtësi. Ky është një kusht i përmbushur dhe Shqipëria nuk ka komoditetin dhe luksin, që për shkak të problemeve të brendshme, të bëjë interpretime për të penguar procesin e hapjes së negociatave, se nuk janë përmbushur kushte që nuk ekzistojnë as në konkluzionet e Këshillit. E dhashë këtë përgjigje, në mënyrë që të jem shterues në raport me pyetjen tuaj, por realisht ju e përmendët faktin se edhe në Gjermani ekziston një shqetësim për reformën zgjedhore.

Pyetja juaj e katërt ishte e lidhur drejtpërdrejt me qëndrimin tim në raport me reformën zgjedhore, përkatësisht procesin ku duhet të adresohen mes të tjerash edhe raportet e ODIHR-it dhe OSBE-së. Ajo që dua të nënvizoj është se reforma zgjedhore ka qenë një element me shumë rëndësi në shërbim të procesit të hapjes së negociatave, por nuk ka qenë një kusht formal për hapjen e negociatave. Kjo ishte për të qenë besnik në raport me konkluzionet e Këshillit të qershorit të vitit 2018. Përkatësisht në paragrafin 54 thuhet se Këshilli i jep një rëndësi të madhe procesit të reformës zgjedhore. Nuk do të thotë që është kusht formal për hapjen e negociatave, sepse, nëse flasim për kushtet formale për hapjen e negociatave, është një diskutim krejt tjetër, që lidhet me faktorët politikë, të cilët mund të jenë ndihmues ose kontributorë shtesë në procesin e hapjes së negociatave. Në këtë kuptim, ne duhet të jemi njëzëri që Shqipëria nuk ka asnjë problem me plotësimin e kushteve për

hapjen e negociatave. Ndërkaq, nëse flasim për diskutimet, që sot ekzistojnë, në rast se forma zgjedhore duhet të ndodhë para hapjes së kapitujve, ky është një proces krejtësisht tjetër. Ne e kemi konfirmuar vullnetin politik për adresimin e rekomandimeve të OSBE-ODHIR-it, por, sidoqoftë, unë këtu jam në kapacitetin e ministrit të Jashtëm në detyrë dhe ky është një proces që i përket Kuvendit të Shqipërisë dhe jo institucionit që unë aktualisht drejtoj. Unë nënvizoj edhe një herë rëndësinë që Shqipëria të ketë natyrisht një sistem zgjedhor me parametrat e duhur ligjorë, që adreson edhe rekomandimet e OSBE-së dhe ODIHR-it, në mënyrë që të krijojë një klimë, ku para se të ketë kontestim të rezultatit zgjedhor në ditën e parë pas zgjedhjeve, të ketë marrje të përgjegjësisë para elektoratit, varësisht prej rezultateve që burojnë nga vullneti i tij.

Rudina Hajdari- Faleminderit, zoti Cakaj, për përgjigjet tuaja shteruese!

Nuk dua të marr më shumë kohë të bëj pyetje të tjera shtesë, sepse edhe anëtarët e tjerë të komisionit kanë dëshirë të flasin.

Zonja nënkryetare, a keni dëshirë të shpreheni?

Atëherë, zoti Ralf Gjoni, fjala është për ju.

Ralf Gjoni - Faleminderit, zonja kryetare!

Zoti Ministër në detyrë, ju falënderoj për gatishmërinë për të ardhur dhe për të ndarë me ne këtu, në Komisionin e Integritetit Europian, pikëpamjet tuaj, por edhe gatishmërinë për përgjigjet e qarta dhe të sinqerta ndaj shqetësimeve që ne kemi si deputetë!

Unë nuk besoj se ka ndonjë deputet në këtë komision që do të donte të mos hapeshin negociatat. Kam përshtypjen se ne jemi të gjithë të bashkuar, përtej çdo përkatësie politike, për hapjen sa më shpejt të këtyre negociatave, sepse mjaft janë vonuar. Këtu flas edhe me kapacitetin e një ish-punonjësi në Ministrinë e Punëve të Jashtme.

Ju folët për meritat e Shqipërisë, që janë më të mëdha se në vendet e tjera të rajonit. Unë e ndaj me ju deri diku këtë mendim, por, nëse i hedhim një sy opinionit dhe progresraportit të fundit të Komisionit Europian të vitit 2019, më lejoni t'ju citoj: "Sistemi i drejtësisë tregon një farë niveli përgatitor", pra, "*some level or preparation*", sepse mediat shqiptare nuk e kanë përkthyer siç duhet. Lufta kundër korrupsionit, një farë niveli; lufta kundër krimit të organizuar, prapë, njëfarë niveli përgatitor; kriteri ekonomik, pak progres në drejtim të zhvillimit të një ekonomie tregu funksionale dhe reforma e administratës publike, nivel të moderuar përgatitor. Pavarësisht shqetësimeve të shprehura nga Komisioni, Këshilli ka marrë një vendim që brenda këtij viti, dhe jo më vonë sesa tetori i vitit 2019, të merret një vendim i qartë dhe substancial në drejtim të hapjes së negociatave për Shqipërinë, vendim që

ne patjetër e përshëndesim. Pra, është mirë ta ndajmë shapin nga sheqeri edhe me partnerët tani në Bashkimin European, nëse ata na duan në këtë familje apo jo. Unë e kuptoj vështirësinë ku gjendet institucioni juaj, por po e marrim të mirëqenë se negociatat do të hapen në tetor, dhe duhet të hapen, ne nuk duhet të flasim më politikisht nëse duhet të hapen apo jo, por ne duhet të bisedojmë sot në këtë komision për nivelin përgatitor të Shqipërisë në procesin e bisedimeve për anëtarësim. Në këtë kontekst, unë kam 3-4 pyetje, por që janë të lidhura me njëra-tjetrën, nuk janë të ndara.

Pyetja e parë: ku jemi me përgatitjen e procesit të negociatave? Sa grupe pune, dhe ju kërkoj një përgjigje të saktë dhe konkrete në këtë drejtim, dhe jo deklarata politike, janë ngritur nga ministria e linjës, koordinatorë Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme në këtë drejtim? Kush janë negociatorët? Kush do të negociojë me Komisionin European? Kush janë këta persona, çfarë kapacitetesh profesionale dhe administrative kanë? A kemi ne nevojë për ekspertizë të huaj që t'i bashkëngjitet ekspertizës kombëtare në procesin e negocimit? Si po koordinohet aksioni ndërinstitutional me ministrinë e linjës për kapitujt respektivë që do të hapen, në mënyrë të veçantë 23 dhe 24?

Ju me të drejtë përmendët rolin e deputetëve dhe të parlamentit, po, është e vërtetë që parlamenti ka një rol të rëndësishëm dhe substancial për sa i përket dimensionit të diplomacisë parlamentare, sidomos, për sa i përket anës praktike të negociatave, sepse ne te gjithë si deputetë, sidomos ne që kemi punuar në politikë të jashtme kemi kontakte personale dhe institucionale me homologët tanë në vende anëtare dhe, sidomos, në vende skeptike, por, më falni, zoti Ministër, unë deri sot, jo vetëm si ish-zëdhënës i Ministrisë së Jashtme, por edhe si nënkryetar i Komisionit të Punëve të Jashtme, edhe si anëtar i Komisionit të Integrimit nuk kam marr asnjë kërkesë dhe asnjë ftesë nga Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme për sa i përket angazhimit tim personal dhe diplomatik, *vis a vis* këtyre homologëve dhe miqve që ne kemi në vende, si: Gjermania, Franca dhe Holanda. Ajo që unë dua të them është se kërkohet një koordinim më i fortë, ku ju si ministri duhet të na shtyni dhe të na jepni informacion se ku keni nevojë që ne të ndërhyjmë me kontaktet tona diplomatike. Jam i sigurt që ju e kuptoni këtë.

Sa marrëveshje bashkëpunimi kemi aktualisht me vendet e Europës Qendrore dhe Lindore, të cilat e kanë kaluar procesin e negociatave dhe janë anëtarësuar në Bashkimin European dhe a ka një plan veprimi konkret, relevant, me këto vende? Pra, me sa vende, si për shembull, Mali i Zi, Sllovakia, Çekia, Polonia e të tjerë, kemi sot marrëveshje konkrete bashkëpunimi, në mënyrë që të marrim ekspertizën e këtyre vendeve në procesin përgatitor të

negociatave? Në këtë drejtim, në vazhden e përgjigjes suaj, unë kërkoj edhe vënien në dispozicion të këtij komisioni të të gjithë dokumentacionit të nevojshëm nga ana e ministrisë për të provuar se çfarë vendimesh janë marrë nga institucioni juaj në drejtim të koordinimit të aksionit të hapjes së negociatave me këto vende dhe me vendet partnere.

Së fundi, zoti Ministër, shumë prej nesh jemi të shqetësuar me deklaratat e fundit të kryeministrit grek Micotaqis për kushtëzimin e vendimit grek në Këshillin European për hapjen e negociatave, sepse po dhunohen të drejtat e minoritetit grek në Shqipëri. Personalisht, duke njohur dhe vlerësuar maksimalisht kontributin dhe rolin e minoritetit grek të mirintegruar në Shqipëri, mbeta i habitur nga këto deklarata dhe besoj se edhe kolegët e mi dhe qytetarët e kanë këtë shqetësim. Më fal, për çfarë po flet kryeministri grek dhe a jeni ju aktualisht në bisedime me Greqinë për t'i kërkuar llogari, qoftë ambasadës greke në Tiranë, qoftë Ministrisë së Jashtme në Athinë përmes notave verbale, se për çfarë dhunimi të të drejtave të minoritetit grek e ka fjalën kryeministri Micotaqis? Unë vetë, personalisht, jam me origjinë nga Himara, nuk e ndiej veten grek dhe nuk e kuptoj për çfarë dhunimi të të drejtave të bashkëkombësve grekë në Shqipëri, qytetarëve shqiptarë, e ka fjalën kryeministri grek?! Pse po aludohet për një kushtëzim të hapjes së negociatave me këtë, gjoja, dhunim të të drejtave të minoritetit grek?

Unë kaq kisha, zoti Ministër. Ju falënderoj për një përgjigje koncize, të drejtpërdrejtë dhe të sinqertë!

Faleminderit!

Gent Cakaj - Faleminderit shumë për pyetjet tuaja!

Atëherë, unë po ofroj komente, që shpresoj të bëjnë drejtësi për disa nga çështjet që ju ngritët.

Lidhur me vlerësimin e komisionit, ku diku thuhet se ka një përparim relativ ose një farë niveli të përgatitjes dhe progresit, ose në anën tjetër ku thuhet se ekziston një përgatitje e moderuar për të adresuar disa prej sfidave në fjalë, së pari, për të zbërthyer këta indikatorë, ose këto formulime duhet të kemi në konsideratë tre faktorë:

Faktori i parë është faktori që lidhet drejtpërdrejt me ndryshimin e metodologjisë së vlerësimit nga ana e Komisionit European. Ajo që sot është një farë niveli përgatitjeje, nuk ka qenë e njëjtë me atë të një dekade më parë. Kjo për shkak se sa më shumë është zhvilluar procesi i zgjerimit, aq më rigoroz ka qenë edhe procesi i vlerësimit. Kështu që ne jemi në një situatë, ku duhet ta ndërmarrim reformën në drejtësi, ose të adresojmë kryesisht kriteret që ndërlidhen me kapitullin 23 ose 24, ndryshe nga vendet që kanë filluar procesin e negocimit,

për shembull, me kapitujt për shkencën dhe hulumtimet shkencore ose prokurimin publik. Prandaj, kur këta indikatorë të kuptohen në vetvete, duhet të kuptohen në raport me metodologjinë e re të komisionit.

Elementi i dytë, në zbërthim të vërtetësisë së këtyre indikatorëve, është elementi rajonal. Ndonëse sot flitet dhe diskutohet për një mundësi të shkëputjes së Shqipërisë nga Maqedonia e Veriut, unë ju ftoj, për të qenë diplomatikisht korrekt unë dua të ndalem këtu, të bëni krahasim me indikatorët e vendeve të tjera të rajonit dhe do ta shihni se Shqipëria ka arsye për të qenë shumë krenare për nivelin e reformave dhe për pozicionin e saj në rajon.

Elementi i tretë në zbërthimin e këtyre faktorëve lidhet me faktin që ata korrespondojnë drejtpërdrejt me nivelin, për të cilin po vlerësohet Shqipëria. Nëse do të ketë përparim absolut dhe situatë ideale, me siguri ambicia jonë do të kishte qenë tepër e madhe se sa çelja e negociatave në tetor.

Elementi i dytë: kush do të negociojë; numri i grupeve të punës? Dhe më kërkuat një përgjigje të qartë dhe jopolitike. Unë jam këtu për të dhënë përgjigje të qarta, të sinqerta dhe kompetente. Aktualisht, të gjitha grupet e punës janë ngritur dhe korrespondojnë me numrin e kapitujve, përkatësisht 35, janë grupe pune institucionale dhe funksionale tërësisht.

Procesi i *screening*, ka pasur një vlerë në përmirësimin e cilësisë së organizimit tonë, meqenëse grupeve të punës, që kanë shkuar në Bruksel për t'u njohur me legjislacionin europian për çdo kapitull, në fakt u është dashur të organizohen paraprakisht, të konsolidohen tërësisht dhe të jenë në shkallën e organizimit që është i nevojshëm për vetë procesin e negocimit më pas. Nga kjo pikëpamje, Shqipëria përsëri është në avantazh, krahasuar me vende të tjera të rajonit, përjashtoj Maqedoninë, me të cilat jemi duke e zhvilluar këtë proces në mënyrë paralele, për shkak se vendet e tjera nuk kanë filluar me procesin e shqyrtimit të legjislacionit, kur kanë hapur negociatat, por pas hapjes së negociatave. Nga kjo pikëpamje Shqipëria disponon kapacitetet e nevojshme për fillimin e procesit negociues. Kjo nuk ishte një pyetje juaj, por unë gjej rastin të plotësoj që ne kemi miratuar vendimin e Këshillit të Ministrave për strukturën përgjegjëse që do të zhvillojë negociatat për anëtarësimin në Bashkimin Europian. Përveçse është miratuar VKM-ja, një pjesë e masave legjislative është përmbushur, në mënyrë që të jetësohet në tërësi misioni i kësaj VKM-je. Për shembull, është ngritur platforma e partneritetit, që mundëson përfshirjen e shoqërisë civile në mbikëqyrjen e procesit negociues.

Pyetja tjetër ishte: kush do ta negociojë procesin e anëtarësimit? Do të jap një përgjigje të gjatë, por është në funksion të komunikimit të hapur me ju. Në korrik të vitit të

2018 janë shfaqur dy pozicione të reja në axhendën e integritit, që nuk kanë ekzistuar më parë. Ka qenë titulli i koordinatorit kombëtar për *screening*. Titulli i koordinatorit kombëtar për *screening*, praktikisht, ka qenë pozicioni i kryenegociatorit, por nuk ka mundur të quhet kryenegociator, sepse për të pasur kryenegociator, duhet të ketë negociata, dhe kjo ishte pasqyrë e drejtpërdrejtë e situatës politike ku ka qenë Shqipëria. Fillimisht unë e kam pasur detyrën e koordinatorit kombëtar për *screening* dhe sot këtë detyrë e gëzon zëvendësministri përgjegjës për integrimin në Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme, zoti Sokol Dedja. Nuk mund të ketë kryenegociator të formalizuar politikisht pa pasur një vendim pozitiv për hapjen e negociatave. Në këtë mënyrë ne jemi në pozicionin, ku i kemi të gjitha kapacitetet teknikisht aktive, por politikisht nuk mund t'i emërojmë në kapacitet që ju kërkuat.

Së fundi, ju nënvizuat rëndësinë e faktit për të thelluar bashkëpunimin me vendet e Europës Qendrore, Lindore dhe Juglindore, që kanë kaluar në procesin e negocimit para nesh, në mënyrë që të këmbejmë përvoja. Deri sot ky bashkëpunim është kurorëzuar në dy nivele: niveli i parë ka qenë marrja e drejtpërdrejtë asistencës teknike prej këtyre vendeve. Disa prej ekspertëve të tyre shërbejnë në Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme, janë fizikisht të pranishëm aty dhe një pjesë e tyre ofrojnë këshilldhënie nga nevoja.

Niveli i dytë i marrjes së asistencës dhe mësimave të vlefshme, në shërbim të axhendës së integritit, natyrisht ka qenë niveli i konferencave dhe i seminareve të ndryshme, ku qëllimi ka qenë rritja e kapaciteteve profesionale të stafit të Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme, dhe jo vetëm, për t'u përballuar me nevojat e integritit. Sidoqoftë, duhet të kemi parasysh që procesi i rinegocimit është transformuar në mënyrë të konsiderueshme që në momentin kur vendet në fjalë janë anëtarësuar. Natyrisht, kjo nënkupton që ne duhet të kemi një qasje të shtuar në komunikimin me vendet e rajonit, me autoritetet e Bashkimit European në përgjithësi ose me grupet e tjera institucionale, që disponojnë ekspertizën e nevojshme në shërbim të axhendës europiane të Shqipërisë. Pak a shumë, kjo i përmbledh çështjet që ngritët ju.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kërkoj ndjesë! Te çështja e Greqisë: dëshira ime për të qenë i hapur me ju nuk duhet të më shtyhej edhe në një pozicion për të qenë politikisht naiv para jush. Ajo që dua të them: është se me qeverinë pararendëse në Greqi, ne kemi pasur një proces aktiv komunikimi dhe nuk ka pasur barriera në procesin e integritit european. Natyrisht, me qeverinë aktuale jemi në proces të konsultimeve, në mënyrë që të adresojmë të gjitha çështjet që mund të shfaqen si pengesa në ambicien europiane të Shqipërisë. Duhet të keni parasysh që Shqipëria është në

pozicionin, ku merr mbështetje politike dhe kjo është tepër e nevojshme për të pasur një vendim pozitiv në tetor.

Rudina Hajdari – Zoti Gjoni, keni pyetje apo koment?

Ralf Gjoni – Faleminderit, zoti Ministër!

Për ta sqaruar edhe një herë pyetjen. Unë e mirëkuptoj pozicionin tuaj, është pozicion shumë delikat, sidomos vis-a-vis një fqinji, si Greqia, dhe pak javë para marrjes së vendimit të Këshillit European.

Po më lejon ta ripërsëris pyetjen time ose ta riformuloj: a ka pasur shqetësim të shprehur zyrtarisht nga ana e Ministrisë së Jashtme greke ndaj Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme të Shqipërisë për sa i përket dhunimit të të drejtave të minoritetit grek në Shqipëri? Pra, a është deklarata e kryeministrit, Micotaqis një deklaratë e bazuar në komunikime zyrtare mes dy vendeve, apo ka qenë thjesht një deklaratë e spekulative, retorike e politike për mediet për konsum të brendshëm grek?

Faleminderit!

Genc Cakaj – Nuk mund të komentoj as mbi motivet, as mbi llogarit, as mbi qëllimet e çfarëdo lideri për çfarëdo deklarate. Qëndrimet dhe shqetësimet në lidhje me gjendjen e minoritetit grek në Shqipëri janë tërësisht publike dhe jashtë kuadrit të asaj që është komunikuar publikisht unë nuk mund të flas për ndonjë shqetësim më konkret ose më të veçantë.

Faleminderit!

Senida Mesi – Përshëndetje të gjithëve!

Zoti Cakaj, të falënderoj për përmbledhjen, si zakonisht, shumë të strukturuar, sikurse edhe për përgjigjet ndaj kolegëve!

Dua të ndaj me ju një nga ato komente që sapo adresuat, pra se sa krenar duhet të jemi për reformat e realizuara. Sigurisht, në fund të ditës, vlerësimi për njëfarë niveli përgatitjeje apo mesatarisht të përgatitur për një nga ato reforma, që gjithmonë kanë qenë shumë të vlerësuara nga komisioni, ajo për administratën publike, por edhe të tjerat në kuadër të vështirësisë së implementimit dhe implementimi rrënjësor të reformave mendoj se përsëri progresi duket shumë qartazi në të gjitha fletët dhe në të gjitha komentet që komisioni ka përgatitur. Sigurisht, po të mendojmë sot dhe po të kthejmë kokën pas 4 apo 5 vjet, besoj se asnjëri nga ne nuk do ta mendonte, që reforma në drejtësi, në sistemin gjyqësor, do të ishte pikërisht kjo që është sot. Nuk do ta mendonim kurrë që gjysma e gjykatësve dhe e prokurorëve nuk do të pranonin fare të kalonin në procesin e vetingut. Gjysma e gjysmës, që

pranoi ta kalonte këtë sistem të vetingut, edhe ajo nuk po e kalon vetingun. Sigurisht, kjo është një punë jo vetëm e ekzekutivit, kjo është një punë e gjithë Kuvendit, është një punë ku të gjithë deputetët, edhe ata që kanë dalë jashtë parlamentit e të rinjtë që i kanë zëvendësuar, po kontribuojnë dita-ditës në të gjithë paketën ligjore, që, ashtu siç e dimë të gjithë, ka përfunduar në korrik të këtij viti.

Sigurisht, puna e Kuvendit, në kuadër të të gjithë kësaj reforme, ka përfunduar, por ka filluar procesi i monitorimit të zbatueshmërisë së kësaj reforme, me qëllim që vetë institucionet e reja të krijuara me ligj, të cilat kanë buxhetin, institucionet dhe infrastrukturën fizike për të punuar duhet të avancojnë më pas me axhendën e tyre. Sigurisht, këtu dua ta lë jashtë qeverinë, në lidhje me monitorimin apo ndërhyrjen në këtë proces, pasi ky proces në vetvete duhet të ecë tashmë me organet, që janë të pavarura, dhe është puna jonë, si Kuvend, që përherë e më tepër në këto platforma diskutimi, në këto salla mbledhjesh apo edhe në sallat e tjera të kërkojmë llogari, jo vetëm për ecurinë, por ku janë problematikat dhe për çfarë kanë nevojë këto sisteme që ne të avancojmë më këtë axhendë.

Zoti Ministër në detyrë, kemi shumë pak kohë në lidhje me pjesën e diplomacisë së ekzekutivit, në qoftë se duhet ta quaj kështu apo me pjesën e diplomacisë parlamentare. Për hir të së vërtetës, kohët e fundit Komisioni Integritetit Europian ka qenë shumë i rigjallëruar nëse mund ta quaj kështu, në lidhje me çdo kontakt që kemi pasur për ndërmarrë iniciativë së bashku me kolegët deputetë për të takuar pikërisht të ashtuquajturat vende skeptike; për hir të së vërtetës, nuk më pëlqen ky term, por në fund të ditës të gjithë e kuptojnë se çfarë do të thotë ky term. Disa vende shtohen dhe disa ikin. Duket sikur Greqia deri dje ishte një ndër ato vende që po e mbështeste fuqimisht pjesën e integritetit të Shqipërisë dhe hapjen e negociatave. Dhe unë kam një pyetje, por, siç duket duhet, ta elaburojmë pak më tutje. Pyetja ime është: sot që flasim, Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme, sigurisht qeveria së bashku me Kryeministrin, ku janë fokusuar në këto 3-4 javë që kanë mbetur në lidhje me intensifikimin e këtyre takimeve (jam dakord me zotin Gjoni) për të koordinuar punën e diplomacisë parlamentare?

Ne kemi bërë një plan vizitash qoftë me Gjermaninë, qoftë me Danimarkën, me Francën e kemi realizuar, mund të realizojmë përsëri një takim tjetër, me qëllim që jo vetëm të intensifikojmë pjesën e diplomacisë, por t'i bëhemi suport njëri-tjetrit për një proces që të majtët dhe të djathtët brenda dhe jashtë Kuvendit, politikanë, por, kryesisht, mbi 85% e shqiptarëve e duan hapjen dhe fillimin e negociatave.

Faleminderit!

Rudina Hajdari – A keni pyetje tjetër?

Senida Mesi – Nuk kam.

Rudina Hajdari – Urdhëroni!

Genc Cakaj – Para se të jap një përgjigje teknike, konsideroj se parashtrimi më i përgjithshëm i një konteksti politik është i nevojshëm. Konkluzionet e qershorit të vitit 2019 nuk kanë qenë thjesht konkluzione të shtyrjes së vendimit për hapjen e negociatave. Në fakt, në rastin në fjalë, sikurse në shumë raste të tjera në politikë në përgjithësi, suksesi nganjëherë nuk varet vetëm nga arritjet, por edhe nga shmangia e problemeve të mundshme ose skenarëve më negative dhe ajo që Shqipëria ka shmangur në qershor është vendosja e kushteve të reja për hapjen e negociatave. Kjo nënkupton se vlerësimi për Shqipërinë do të bazohet ekskluzivisht në konsideratat, që janë paraqitur në konkluzionet e qershorit të vitit 2018. Kjo është e rëndësishme për të shpjeguar gjithçka për veprimtarinë diplomatike të Ministrisë për Europën dhe punët e jashtme dhe të qeverisë shqiptare në përgjithësi. Për shkak se shumë prej punës që është bërë deri tani nuk është një punë që i takon të shkuarës, por është një kapital që është mbledhur në shërbim të hapjes së negociatave në tetor. Për shkak se shtjellimet, që janë bërë për secilin kusht të posaçëm, janë të njëjtat me të cilat do të vlerësohemi nga Këshilli në tetor të këtij viti.

Sidoqoftë, mund të flas për disa parametra strategjikë të angazhimit tonë për periudhën që po vjen. Natyrisht, secili vend skeptik dhe joskeptik do të vizitohet. Këto ditë unë jam kritikuar edhe për vizitën e shpeshtë nëpër vende që vetë e kanë konfirmuar mbështetjen për Shqipërinë, por, së pari, neve nuk na takon ta marrim të mirëqenë mbështetjen e asnjë vendi.

Së dyti, shteteve që na mbështesin (ne nuk duhet të llogarisim mbështetjen e tyre pro Shqipërisë) duhet t'u kërkojmë lobimin e tyre në vendet ku ato kanë ndikim.

Së fundi, po ashtu, këto shtete nuk duhet thjesht të thonë po, nuk duhet thjesht të japin dritën e gjelbër për hapjen e negociatave, por, në fakt, kanë një rol thelbësor në balancimin e përgjithshëm të konkluzioneve të Këshillit.

Kësisoj, përveç punës së hollësishme dhe të vazhdueshme me vendet skeptike që ka qenë deri tani dhe që do të vazhdojë edhe më tej, që fillon nga vizita jonë në Nju Jork dhe do të vazhdojë deri në ditën e takimit të ministrave të jashtëm për të marrë vendimin për hapjen e negociatave, ne kemi qenë aktivë edhe në krijimin e partneriteteve të reja me shtetet, që, mbase, nuk janë euroskeptike, por do të kenë rol thelbësor qoftë edhe në marrëdhënie me vendet euroskeptike. Euroskeptike është një term që unë e përdor, meqenëse u përdor këtu,

sepse nuk është pjesë e fjalorit tim politik, sepse për mua është term i paqëndrueshëm, por meqenëse përdoret gjerësisht në zhargonin politik, besoj se është qartë ajo që po aludoj. Atëherë, ne kemi pasur marrëdhënie të konsoliduara qoftë me vendet mbështetëse, që mund të kenë rol pozitiv në vendet që kanë rezerva për sa i përket hapjes së negociatave, qoftë për të fuqizuar qëndrimin politik pro Shqipërisë në vendimin e tetorit.

Faleminderit!

Rudina Hajdari – A ka pyetje të tjera nga komisioni? Nëse po, tani është momenti që të bëhen pyetjet dhe më pas të përgjigjet zoti ministër.

Urdhëroni, zoti Papa!

Më pas fjalën e ka zonja Hyseni.

Kostaq Papa – Faleminderit, zonja kryetare!

Përshëndetje, zoti Ministër në detyrë, dhe faleminderit për përpjekjen që bëni për një pasqyrim real të gjendjes!

Para se të ndalem te 2-3 pyetje, dua të mbështes zotin Gjoni për atë që tha në lidhje me dëshirën e të gjithë deputetëve për integrimin e Shqipërisë dhe për marrjen e datës së caktuar. Kështu që këtë nuk duhet ta vërë asnjëri në dyshim, por duhet të bëjmë edhe pak opozitë.

Pyetja e parë: si është parë në relacionet e takimeve të ndërsjella, të barasvlershme dhe nga filtri diplomatik, situata dhe kriza politike në Shqipëri, polarizimi ekstrem pozitiv-opozitë me pjesën që është jashtë parlamentit, dhe si është parë në ndikimin që ka në marrjen e datës së çeljes së negociatave?

Pyetja e dytë lidhet me problematikat që na krijon Greqia sa herë kemi për të marrë një datë. Duke parë se fjala e Kryeministrit të ri grek është bërë në seancat parlamentare të parlamentit grek, ku është folur për atë çfarë do të bëjë ai për Shqipërinë, pse nuk i është kërkuar nga Ministria e Europës dhe Punëve të Jashtme komisionit parlamentar apo edhe parlamentit një reagim në lidhje me atë që Greqia ndjek hap pas hapi zhvillimet e Shqipërisë dhe, kur janë momentet që ka për të marrë një datë, një çështje, një detyrim ose një të drejtë, vë nga një gurë të vogël nën rrota, pa indicie, pa realitet dhe e pa mbështetur në fakte? Duke qenë se edhe unë, si zoti Gjoni, jemi nga zona, të cilën më kot zoti Micotaqis përpiqet ta quajë minoritare, unë jam nga 200 kilometra më poshtë, jam mbi Butrint, për të mos thënë edhe origjinën time nga Moreja, kështu që e di mirë që minoriteti grek gëzon më shumë të drejta se sa ne shqiptarët. Nuk mundet që Greqia, e cila është jashtë konventave që kanë lidhje me minoritetet, të na flasë ne për minoritetet, kur i ne kemi pranuar më tepër nga sa

janë, kur nuk ka minoritete dhe ne i kemi quajtur minoritete, për efekt të cilësisë së veçantë që ka Shqipëria dhe shqiptarët, si njerëz që nuk i sulmojnë të tjerët, por i barasvlerësojnë me veten. Pra, kërkoj një reagim nga ana juaj.

Së treti, në 6 dhe 8 vjetët e fundit u cikluan në diplomaci ish-ambasadorë dhe funksionarë të tjerë diplomatikë të të gjitha rangjeve, që kanë qenë të periudhës së diktaturës. Si konsiderohet ky grup diplomatësh nga relacionet e ministrisë suaj? Ndoshta, mund të mos keni një përgjigje, por do të doja një relacion më të plotë lidhur me shifra, fakte dhe për ndikimin e tyre në proceset e integritetit, për problemet e diasporës, si dhe të atyre që ata kanë lidhje me çështjet e emigracionit, të diasporës, të mbulimeve shqiptare dhe se çfarë kanë bërë ata sa u takon problematikës së trojeve etnike.

Ju, ndoshta për momentin mund të mos keni ndonjë përgjigje, por përfaqësuesit e ministrisë suaj, ndoshta edhe ju, nëse ma jepni të drejtën si anëtar i komisionit dua t'ju kërkoj një relacion të plotë për këto ndikime, jo vetëm për vlerën e historisë demokratike, por konkretisht ndikimin që kanë dhënë për integritetin e vendit tonë, e cila është gjëja më e domosdoshme, sepse shqiptarët si shumica absolute kërkojnë të jenë pjesë e Europës.

Faleminderit!

Edlira Hyseni – Përshëndetje!

Zoti Ministër, ju falënderoj për bashkëbisedimin dhe për prezantimin që u bëtë të gjitha çështjeve, për të cilat ka një interes jo vetëm nga ana jonë si deputetë, por edhe si qytetarë.

Gjatë fjalës suaj, kur na bëtë prezantimin, më tërhoqi vëmendjen gjatë fjalës suaj të parë, e të gjitha çështjeve të integritetit, që është shumë e dëshiruar nga të gjithë ne, diku nga fundi ju u shprehët: “Në fund të fundit vendimi i Këshillit të Europës, i herëve paraardhëse, ka qenë një vendim politik, ndërsa ato të Komisionit European kanë qenë vendime teknike”. Është pak a shumë ajo që artikullohet shpesh, sepse ju thatë që Këshilli European ka pasur problematikat e veta lidhur me zgjedhjet europiane e të tjera, pra kanë ndikuar një sërë faktorësh politikë nga ana e tyre, të cilat na kanë penalizuar dhe në këtë mënyrë nuk na është pranuar hapja e negociatave disa herë që është kërkuar, ndërsa Komisioni European në relacionin e tij teknik ka parashikuar se ne i kemi plotësuar kushtet për t'i hapur këto procese.

Unë dua të di, mos ndoshta kjo bindje nga ana jonë, ne e meritojmë dhe nga ana teknike, jemi gati, por është Europa, e cila për problemet e veta politikisht na ka “penalizuar” me të padrejtë, në një farë mënyre ka dekurajuar punën dhe impenjimin maksimal që të

arrihej përmirësimi dhe realizimi i plotë i rekomandimeve për të cilat ne i kemi kushtet që të hyjmë?

Në tetor, i cili vjen pas pak, në përfundim, ne duhet të presim një vendim politik, teknik apo të dyja bashkë? Gjithashtu, doja të dija nëse ju personalisht apo institucionalisht jeni besimplotë dhe mendoni se do të kemi hapje të negociatave pa kushte, me kushte apo ekziston edhe mundësia e moshapjes së negociatave?

Faleminderit!

Gent Cakaj – Po filloj nga pyetja e fundit, pasi e konsideroj tepër të rëndësishme dhe në dritën e sfidave që po vijnë. Ne presim hapjen e negociatave, të negociatave me kushte, pa kushte apo moshapje absolute të negociatave. Problemi i parë është përkufizimi se çfarë nënkuptojnë negociatat me kushte, sepse vetë koncepti i negociatave nënkupton plotësimin e kushteve shtesë. Në fakt, nuk është negociim nëse do t'i plotësojë ose jo kushtet Shqipëria apo nëse Shqipëria do të shmangë ndonjë kusht. Ajo çka ne i referohemi zakonisht si proces i negociimit për anëtarësim nuk është gjë tjetër në fund të ditës veçse zhvillimi i dy proceseve paralelisht, procesit të përafrimit të legjislacionit vendor me atë europian dhe plotësimi i kushteve shtesë që ndoshta mund të shfaqen edhe nga vlerësimi politik i vendeve anëtare. Kësisoj, nëse do të kemi hapje të negociatave, natyrshëm në vetë procesin negociues do të ketë kushte. Ajo që është më e rëndësishme për Shqipërinë është të marrë një po dhe që Këshilli të mos i kthehet më vendimit për hapjen ose jo të negociatave, kjo është thelbësorja dhe skenari më ideal i mundshëm.

Sidoqoftë, unë po ju listoj këtu skenarë të mundshëm, sepse ky takim nuk është një ushtrim teorik apo shkollor, por neve na takon të përpiqemi për atë që ka qenë ambicia jonë prej kohësh, hapjen e negociatave për anëtarësim. Natyrisht, nuk ka garanci nëse do të ketë hapje të negociatave në tetor, predispozitat fillestare janë pozitive, por, nëse këto predispozita fillestare do të shndërrohen në një vendim pozitiv përfundimtar këtë nuk mund t'jua them tani, por mund t'jua them në një mbledhje tjetër në rast se ju më ftoni para vendimit të Këshillit.

Çështja e dytë është nëse bindja jonë, sepse ky është një problem politik i BE-së dhe jo një situatë teknike e Shqipërisë, është duke u bërë pengesë në ndërmarrjen e reformave.

E para, entuziazmi për plotësimin e kushteve të integritetit europian nuk ka rënë dhe nuk është zbehur, përkundrazi, kjo është krejtësisht e verifikueshme. Nëse shihni shkallën e zbatimit të planit kombëtar për integrimin europian të këtij viti, nga janari e tutje do të vëreni një shkallë të konsiderueshme të përmirësimit në zbatim të saj. Me shkallë të konsiderueshme

kam parasysh mbi 50% më mirë sesa ka qenë. Kjo tregon se dinamika e Shqipërisë nuk është ndikuar negativisht asnjëherë në rrugën e saj europiane.

Elementi i dytë është, natyrisht ka hapësirë për përmirësime teknike, por nuk mund të ketë hapje të negociatave pa një vlerësim paraprak të Komisionit se një shtet që aspirojnë hapjen e negociatave është i gatshëm për t'i hapur ato. Suksesi i parë e kemi arritur, suksesi i dytë është diçka për të cilën po angazhohemi në baza ditore dhe me anë të kësaj po adresoj një pyetje tjetër që u ngrit nga parafolësit. Pyetja ishte nëse mund të ketë probleme shtesë dhe pse shtete të caktuara shkaktojnë vazhdimisht probleme në rrugën europiane të Shqipërisë, si dhe u nënvizua nga ju çështja nëse për Shqipërinë do të ketë një vlerësim politik, teknik ose të dyja bashkë?

Natyrisht, përderisa vendimi politik pozitiv i Këshillit duhet të mbështetet detyrimisht në vlerësimin teknik pozitiv të Komisionit, jo domosdoshmërisht pas një rekomandimi pozitiv teknik vjen edhe një vendim politik pozitiv. Vendimi i tetorit do të jetë edhe teknik, edhe politik dhe ne jemi të angazhuar në përmirësimin dhe shtimin e gjasave për një vendim politik në qershor.

Pyetja tjetër ishte për cilësinë e një vargu diplomatësh në Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme. Unë konsideroj se është më e vlefshme ta shmang në tërësi, meqenëse kjo nuk është tema e ditës së sotme. Në fund u parashtrua edhe një pyetje në lidhje me situatën politike në Shqipëri dhe ndikimin e saj në procesin e integritetit europian.

Janë një sërë faktorësh që duhet të përmenden.

E para, pavarësisht situatës politike në Shqipëri, gjasat për hapjen e negociatave nuk janë shuar. Kjo do të thotë se kërkohet angazhimi dhe sjellja politike e gjithsecilit për të mundësuar që ajo që është aspiratë historike sot të bëhet realitet nesër. Kushtet që i janë kërkuar Shqipërisë për hapjen e negociatave janë plotësuar. Përgjegjësit politikë për një varg problemesh që ekzistojnë në Shqipëri po ashtu janë listuar në rekomandimet e Komisionit, si dhe në vlerësimet e fundit të ODIHR-it për zgjedhjet e 30 qershorit. Nuk i takon qeverisë shqiptare të marrë përgjegjësinë për veprimtarinë e asnjë aktori politik që vendos të bëjë atë që është duke bërë, por të shfaqë vullnetin e plotë në shërbim të përmirësimit të situatës ekzistuese dhe të lehtësimit të agjendës së saj europiane, duke ofruar gatishmërinë për adresim të plotë dhe pa asnjë ekuivok të rekomandimeve të OSBE-ODIHR-it për të konsoliduar sistemin elektoral dhe cilësinë e demokracisë në Shqipëri në përgjithësi.

Unë mund t'ju jap një përgjigje më politike se sa kjo, por këtu jam në Komisionin për Integrimin Europian dhe përgjigjet e mia duhet të jenë të ekuilibruara, konform kërkesave të një çështjeje nacionale, siç është kjo.

Rudina Hajdari – Faleminderit, zoti Cakaj!

Nëse nuk ka pyetje të tjera, do të doja t'ju bëja një rezymë për çfarë u tha gjatë këtij takimi. Unë mendoj se është mjaft e rëndësishme, sidomos për opinionin publik, të kuptojmë se Komisioni i Integritetit është një komision kontrollues ndaj qeverisë, ndaj do të donim që në vijim të kishim një bashkëpunim sa u përket akordimeve ndërinstitucionale për të zbatuar planin e veprimit afatshkurtër në lidhje me hapat e mëtejshme për hapjen e negociatave.

Gjithashtu, ju thatë se disa vende skeptike kanë argumentuar, se disa prej tyre kanë interesin e problemit të zgjerimit, disa të tjera problemin e luftës ndaj krimit të organizuar dhe unë mendoj se këto argumente shkojnë me njëra-tjetrën. Pra, nëse këto vende kanë problemin e zgjerimit, atëherë ato e justifikojnë me faktin që Shqipëria e ka këtë problem, që është shkalla e krimit të organizuar. Duke qenë se këto vende janë skeptike për shkak se janë kundër zgjerimit, kjo nuk do të thotë se ne nuk duhet të merremi me problemet tona, por duhet t'i adresojmë ato dhe të kemi një bashkëpunim ndërinstitucional. Ne si komision i jemi drejtuar disa herë ministrit të Brendshëm që ai të ishte pranishëm dhe të na sqaronte sa u përket dy pikave kryesore, lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, pasi kompetencat e tij janë më shumë në luftën kundër krimit të organizuar.

Gjithashtu, ju na thatë se funksionimi i SPAK-ut apo i BKH-së nuk është i nevojshëm për hapjen e negociatave, përkundrazi unë mendoj se ngritja e këtyre organeve duhet të bëhet sa më shpejt, pasi është një kërkesë e qytetarëve shqiptarë, të cilët mezi po presin ngritjen e këtyre organeve. Sa i takon kësaj pike duhet ta argumentojmë në këtë prizëm, si interes i qytetarëve shqiptarë. Patjetër që ndërkombëtarët luajnë një rol të rëndësishëm sa i takon reformës në drejtësi, por e vërteta është se paketa e reformës në drejtësi u plotësua në korrik falë qëndrimit të opozitarëve në parlament. Nëse nuk do të kishte qenë roli i votave të opozitarëve në parlament, atëherë kjo reformë sot nuk do të ishte zbatuar.

Çfarë do të thotë kjo? Duke qenë se reforma në drejtësi është një nga reformat kyçe për shqiptarët, edhe hapja e negociatave me kushte apo pa kushte nëse ato do të hapen, do të ndodhë për shkak të qëndrimit të opozitarëve në parlamentin shqiptar. Nëse kjo nuk do të ishte sot realitet, ne nuk do të ishim në gjendje të zbatonim reformën në drejtësi, të diskutonim për çeljen e negociatave, si dhe të diskutonim mundësinë për një reformë

zgjedhore gjithëpërfshirëse, një reformë me një nivel dhe cilësi më të mirë për qytetarët shqiptarë.

Ju falënderoj për të gjitha përgjigjet që na dhatë! Sa u takon bisedimeve që keni pasur me kancelaren Merkel, nëse është e mundur të na dërgonit një shkresë sa u takon pikave që keni diskutuar, sepse ju thatë se nuk mund të na i thoshit bisedat që keni bërë gjatë takimeve në Bundenstagun gjerman. Në mos gaboj kjo është një dilemë juaja?

Gent Cakaj – Unë ju thashë disa nga mesazhet e përgjithshme gjatë takimeve, por nuk citova asgjë konkrete nga takimi që kemi pasur në Gjermani, sepse do të ishte një sjellje tërësisht jo në përputhje me Kodin Elementar të Sjelljes për takime të tilla të rëndësishme.

Rudina Hajdari – Nëse keni ndonjë gjë sa u takon temave konfidenciale, nëse është e mundur do të doja t'i trajtojmë në një takim të mbyllur pa praninë e medieve, sepse është e rëndësishme që Komisioni i Integritetit të informohet sa u takon këtyre pikave të nxehta. Po ju kujtoj se Gjermania e merr vendimin për çeljen e negociatave me një vendim të Bundestagut, i cili do të kalojë jo në qeverinë gjermane, por në filtrat e Bundestagut gjerman, e cila kërkon konsensusin e të gjithë parlamentarëve atje. Ne kemi parë që brenda fraksionit të CDU-së ka problematika të rëndësishme sa u përket kërkesave të tyre në lidhje me trajtimin dhe ndëshkimin e korrupsionit të politikanëve në nivele të larta, të cilët kanë pasur probleme me ligjin, prandaj ne duhet t'u tregojmë që jemi të gatshëm për t'i zbatuar këto kërkesa dhe t'u tregojmë që kemi rezultate në këtë prizëm, por edhe sa u takon kërkesave të tjera që lidhen me reformën në drejtësi.

Së fundi, kisha diçka për diplomacinë parlamentare. Diplomacia parlamentare është shumë e rëndësishme, siç u thashë rastin e Gjermanisë, por ka edhe shumë vende të tjera që kalojnë në filtrin e parlamentit të vendeve respektive, duhet patjetër të funksionojë. Në takimet tona bilaterale, multilaterale këtë gjë e kemi problem, sepse nuk e dimë se në çfarë pike jeni ju si qeveri në lidhje me zbatimin e pikave kyçe për të cilat flitet dhe përflitet çdo ditë, sidomos sa i takon luftës kundër krimit të organizuar dhe të korrupsionit në vend.

Unë mendoj se këto janë dy çështje shumë të rëndësishme për të cilat ne duhet të shkëmbejmë informacion për hir të qytetarëve shqiptarë, të Shqipërisë në mënyrë që të avancojmë në këtë drejtim.

Këto ishin pikat që doja t'ju përmendja.

Zoti Ministër, faleminderit shumë për praninë tuaj në komision dhe mendoj se do të shihemi në ndonjë rast tjetër!

MBYLLET MBLEDHJA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Integrimin Europian

PROCESVERBAL

Tiranë, më 17.09.2019, ora 12:15

Drejton mbledhjen:

Rudina Hajdari – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit “Për ndryshimet klimatike”.

Marrin pjesë:

Mungojnë:

Të ftuar:

Ornela Çuçi – Zëvendësministre e Turizmit dhe të Mjedisit

Athanas Karaja - Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë Rregullatore dhe Perputhshmërisë në Turizëm dhe Mjedis

Klodiana Marika - Drejtore e Programeve të Zhvillimit të Mjedisit në Ministrinë e Turizmit dhe të Mjedisit

Vilma Kola -Drejtore e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Mjedisit Mjedisit në Ministrinë e Turizmit dhe të Mjedisit

Eneida Rabdishta - Specialiste e Drejtorisë së Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Mjedisit në Ministrinë e Turizmit dhe të Mjedisit

Rudina Hajdari – Vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës, shqyrtimi i projektligjit “Për ndryshimet klimatike”.

Të pranishëm në komision janë përfaqësues nga Ministria e Turizmit dhe e Mjedisit, zonja Ornela Çuçi, zëvendësministre, zonja Klodiana Marika, drejtore e Programeve të Zhvillimit të Mjedisit, zonja Vilma Kola, drejtore e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Mjedisit, zonja Eneida Rabdishta, specialiste e Drejtorisë së Politikave dhe Strategjive të

Zhvillimit të Mjedisit, si dhe zotin Athanas Karaja, drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë Rregullatore dhe Përputhshmërisë në Turizëm dhe Mjedis.

Fjala është për ju zonja Çuçi.

Ornela Çuçi – Përsëritje!

Ne kemi sjellë para jush projektligjin “Për ndryshimet klimatike”, i cili është një nga bazat ligjore që nevojitet në mënyrë të jashtëzakonshme për efektin e ndryshimeve klimatike në Shqipëri. Ndryshimet klimatike tashmë janë kryefjala për mjedisin. Në fakt, në të gjithë botën, ne shumë pak e kemi prekur këtë problem në Shqipëri në mënyrë sporadike, por ka ardhur momenti, edhe për shkak të Kapitullit XXVII të aderimit tonë në Bashkimin Europian të vendosim kuadrin ligjor për çështjen e ndryshimeve klimatike çka jua kemi parashtruar përpara.

Ne sapo kemi mbaruar miratimin e strategjisë kombëtare për ndryshimet klimatike dhe emetimin e gazeve me efekt serrë që lidhet direkt me këtë ligj dhe tashmë vijmë me hapin e dytë shumë të rëndësishëm për ndryshimet klimatike, i cili është ligji që ju keni përpara. Ndryshimet klimatike ndonjëherë perceptohen si një koncept që ndodh diku në Artik dhe baza dhe slogani i OSBE-së është: “Çfarë ka ndodhur në Artik nuk ngelet vetëm në Artik” dhe kjo reflektohet më së miri në Shqipëri, sepse ne jemi një ndër 40 vendet e para të impaktuara nga ndryshimet klimatike, ndonëse nuk impaktojmë si vend jemi shumë më të impaktuara nga ndryshimet klimatike. Në gjithë listën e vendeve të OKB-së përmendemi në 40 vendet e para.

Në këtë kuadër, edhe për shkak të përafrimit tonë me legjislacionin e Bashkimit Europian kemi si detyrim përafrimin e këtij legjislacioni kombëtar në ndryshimet klimatike konkretisht hartimin e projektvendimit për Rregulloren, monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë dhe të informacioneve të tjera që lidhen me ndryshimet klimatike në nivel kombëtar. Legjislacioni që ju keni përpara nuk është përafruar plotësisht dhe arsyeja është, ka 3 vjet që diskutohet në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit pse nuk e kemi përafruar plotësisht, se është një nga ligjet ose direktivat më shumë të kushtueshme sot për sot dhe Shqipëria nuk është ende gati për ta transpozuar *mot a mot* këtë direktivë. Jemi përqendruar në nevojat kryesore që ka vendi, të cilat kanë të bëjnë me monitorimin dhe raportimin e gazeve me efekt serrë për të cilën, siç edhe jua thashë më lartë, kemi miratuar strategjinë kombëtare.

Nuk kemi shkuar në pikat më kyçe të direktivës siç është tregtimi i gazeve me efekt serrë, sepse nuk e gjejmë ende vendin në nivel të tillë për të shkuar deri në këto pika. Pra,

jemi përqendruar te monitorimi dhe raportimi, por shkak kryesor, në fakt, ka të bëjë me integrimin europian dhe ne kemi detyrime të jashtëzakonshme për të raportuar në lidhje me gazet me efekt serrë, jemi përqendruar 100% në transpozimin e konventës të ndryshimeve klimatike. Në vitin 2015 kemi firmosur marrëveshjen e Parisit dhe në kuadër të kësaj marrëveshjeje jemi pjesë e konventës për ndryshimet klimaterike. Në këtë mënyrë na u desh që kjo bazë ligjore të përshtatej me konventën për ndryshimet klimatike dhe terminologjia e të gjithë ligjit është e përshtatur me të gjithë konventën, por në statusin *non annex I*, që Shqipëria përfaqëson. Sigurisht përafrimin e kemi bërë si një vend kandidat duke punuar intensivisht për të filluar negociatat për t'u bërë vend anëtar i Bashkimit Europian.

Nëse doni që unë të futem në çështje teknike të ligjit, më thoni, ju lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Rudina Hajdari –Faleminderit, zonja Çuçi, për këtë prezantim të projektligjit për ndryshimet klimatike!

Dua të bëj disa pyetje për ju apo ekspertët tuaj në lidhje me këtë projektligj. Në faqen nëntë të relacionit të projektligjit parashikohet mbulimi buxhetor për zbatimin e këtij ligji dhe janë paraqitur mënyrat e financimit si nga buxheti i shtetit, BE dhe donatorë të tjerë, si edhe hendeuku financiar. Çfarë nënkuptohet me këtë gjë dhe si do të mbulohet ky hendeq financiar? Kam edhe dy pyetje të tjera, nëse mundem.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do të bëjmë pyetjet, pastaj përgjigjet.

Ne si vend kemi një problematikë shumë të madhe për sa i përket ndotjes së ambientit, në nivelet ndoshta më të larta. Pyetja tjetër që shtrohet për ju është: sa ndikon ky projektligj në uljen e ndotjes mjedisore të ajrit? Vetëm në qarkun e Tiranës janë disa sipërmarrje që ushtrojnë aktivitete me pasoja të larta për sa i përket ndotjes, e cila ndikon drejtpërdrejt në shëndetin e banorëve, këtu flas për disa fabrika që ndodhen në periferi të Tiranës dhe shumë prej tyre nuk kanë leje mjedisore dhe shkarkimi i tymrave të shumtë shkakton pasoja në shëndetin e tyre. Nëse kjo është një gjë për të cilën ju jeni në dijeni, mund të më informoni pak më shumë në lidhje me ndotjen që po ndodh në periferi të Tiranës në lidhje me këto fabrika të cilat janë kthyer në problem për banorët e Tiranës.

Ornela Çuçi - Së pari, sa i përket ndotjes në Shqipëri, nuk rezulton të jetë në nivelet më të larta. Shqipëria, fatmirësisht ose fatkeqësisht, nuk ka industri të rëndë, e cila të prodhojë këto nivele ndotjesh. Së dyti, ne jemi një nga vendet unike në të gjithë planetin që prodhojmë 100% energji të pastër, 100% energji green, që është e bërë nga *hider power*. Jemi

vetëm ne dhe Botani në të gjithë botën, kështu që shkaku kryesor i ndotjes në të gjithë botën ka të bëjë me energjinë. Deri tani kemi fatin të prodhojmë e të kemi energji të pastër dhe nuk konsiderohemi si vend me ndotje të madhe. Ajo çka na raportohet sot nga Kombet e Bashkuara është që ne mund të konsiderohemi ndër vendet e papastra për shkak të mosmenaxhimit të hershëm, por jo nga vendet më të ndotura, të them të drejtën.

Ju folët për një hendek financiar, unë do ë doja të thosha që ky ligj nuk ka kushtëzim financiar, sepse gjithçka që është e përshkruar në tabelat që ju shikoni në raport ka të bëjë me PBA-në e katër vjetëve në vijim të të gjitha ministrive. Aktualisht, ndryshimet klimatike janë një fushë multisektoriale. Të gjitha ministritë janë pjesë e zbatimit të këtij ligji, duke filluar që nga Ministria e Energjisë, ajo e Transporteve, Infrastrukturës. Në këtë mënyrë e gjithë çka ato kanë të parashikuar në PBA-në e përbashkët për katër vjetët e ardhshëm është e parashikuar në ligjin që ju shikoni, kështu që hendek financiar nuk ka për ligjin, por ka për zbatimin e strategjisë që shoqëron këtë ligj dhe që është strategjia për zhvillimin me efekt serrë.

Gjithashtu, ju thatë që për qarkun e Tiranës ka disa biznese me efekt të lartë ndotjeje. Po, keni të drejtë, në fakt. Ajo që do doja të thosha është që ky ligj prek aktualisht për katër vjetët që do të vijnë vetëm trembëdhjetë biznese në Shqipëri, të cilat kanë emetime të jashtëzakonshme në ajër, të emetimit të dioksidit të karbonit, si: prodhimi i çimentos, Altea, Kuurumi. Të tilla biznese prodhojnë në nivele të jashtëzakonshme CO₂, pra dyoksid karboni dhe gaze të tjera, të cilat shkaktojnë efektet serrë. Nuk prek të gjitha bizneset në vend, aktualisht prek vetëm këto të trembëdhjeta, dhe ne i kemi lënë kohë vetes gjashtë muaj për t'u përgatitur për aktet nënligjore që do të pasojnë këtë ligj. Nga ana tjetër, i kemi dhënë vetes katër vjet të përgatitemi nga ana institucionale për t'u përballur me çështjet klimatike.

Ajo që unë do të specifikoja është që këto 13 biznese do të duhet të kenë vetëvlerësimin e tyre të ndikimit në mjedis, të cilin e kanë detyrim ligjor. Aktualisht do ta paraqesin çdo gjashtë muaj, për shkak të lejes së tyre mjedisore, në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit. Gjithashtu, do të shtojnë një raport për këto ndryshime për shkak të emetimit të këtyre gazrave, që shkaktojnë efektin serrë.

Ju pyesni për disa biznese që kanë leje mjedisore. Ne kemi një inspektorat të gjithin në këmbë, kemi një Agjenci Kombëtare të Mjedisit. Sigurisht që mund të ketë edhe ndonjë abuzim nga ana e bizneseve. Ju lutem, na i raportoni ose na thoni ku dhe ne do të shkojmë menjëherë të konstatojmë këto lloj ndotje që ju na thoni! Ka ditë për ditë nga një kontroll,

por, nëse ju jeni në dijeni të një gjëje që ndoshta nuk është në kontroll për momentin, na e raportoni dhe ne do të shkojmë ta ndjekim menjëherë!

Rudina Hajdari - Zoti Papaj, meqë zonja u përgjigj, patjetër do ta keni fjalën dhe do të bëni pyetjen sapo ta mbaroj unë.

Kishit diçka për të thënë në lidhje me këtë? Atëherë, në lidhje me pyetjet, kisha një koment të vogël, ju thatë që ne prodhojmë energji të pastër sikurse vendet e tjera në rajon.

Ne jemi një nga vendet që japim leje për hece dhe impaktet që këto hece ndotin mjedisin janë madhore dhe keni një qortim madje nga Komisioni European në lidhje me licencimin e këtyre lejeve për ndërtimin e heceve, sepse kanë impakt mjedisor, kanë impakt në lidhje me faunën, kanë një impakt edhe mbi njerëzit që banojnë në këto zona me turizmin etj. Pra, është një impakt shumë i madh, i cili është akoma duke u parë me vëmendje, por është lëshuar një kritikë ndaj Shqipërisë dhe vendeve të rajonit. Në lidhje me këtë gjë me ndërtimin e heceve me të cilat po abuzohet në një masë jashtëzakonisht alarmante në lidhje me vendin për impaktin që ato kanë mbi mjedisin dhe në natyrën tonë të bukur.

Në lidhje me pyetjen e fundit që ju shprehët, po patjetër do t'ju sjell shembull dy fabrika, njëra është në Laprakë, tjetra në Kamëz, njëra është për prodhimin e tullave dhe ka pasur disa banorë, të cilët kanë dalë në protesta në lidhje me këtë shqetësim dhe do të jenë prapë ditën e diel aty. Banorët më kanë kërkuar e më kanë thënë, gjithashtu, që janë takuar me pronarin e këtij subjekti, i cili u ka premtuar që në tre muajt në vijim do të vënë filtra të tjerë, si dhe do të marrin masa të tjera në mënyrë që të kenë një ambient më të pastër. Por ju e dini mirë që, nëse nuk ka një inspektorat apo një ministri që i gjobit këto kompani që shkaktojnë ndotje të tilla, atëherë ato nuk kanë për të marrë asnjë lloj mase.

Këto janë dy shqetësimet që unë dua të shtroj me ju. Nuk ishin pyetje, ishin thjesht komente dhe, nëse doni informacione shtesë, do t'ju japim me anë të emailit ose diçka e tillë.

Atëherë, zoti Papa, fjala për ju.

Kostaq Papa—Faleminderit!

Unë doja të ndërhyja pak në lidhje me elementet ndotëse. Ajo çka është fare e thjeshtë për t'u gjykuar për Tiranën, deri në vitin 2013 në shtatë njësitë e pikave matëse në Tiranë dhe konkretisht pika kryesore që është tek 21 Dhjetori, elementi i grimcave në ajër ishte katër deri në shtatë herë më i lartë se niveli i Bashkimit European. Mendoni që nga viti 2013 deri në vitin 2019 kjo është bërë zero, pra nuk kemi ndotje, në një kohë që banorët e Tiranës janë të mbingarkuar me grimca në ajër dhe atë që përthithin? Sipas statistikave të shëndetësisë, kemi

rreth 2300 apo 3000 veta që vdesin në spitalet e Tiranës me efekt kryesor elementet dhe papastërtinë në ajër. Kështu që ju jeni specialistë, si ne, ju jeni intelektualë si ne, por t'i heqim hartimet e të bëjmë punën e specialistit. Zotëria ka qenë prefekt, e njeh mirë ndotjen mjedisore në qarkun e Elbasanit, ne kemi banuar kaq vite në Tiranë dhe e njohim mirë ndotjen që kanë bërë firmat dhe ndërmarrjet, të cilat herë pas here mbijnë si kërpudhat pas shiut në fund të lagjeve të Tiranës. Kështu që të shohim se çfarë mund të bëjmë, qoftë ne si politikë, qoftë ju si njerëz të fushës që merreni me këtë punë, për ndikimin real në pastrimin e ajrit. Nuk shohim, në fakt, ndonjë përmirësim. Kjo ndotje e krijuar në kuadrin e rigjenerimit të qytetit dhe lagjeve po e shton ndotjen, po zvogëlon hapësirën për metër ajrim dhe gjelbërimi të domosdoshme për qytetarin. Nuk dua të ndalem në kontradiktën pozitive -opozitive për këto elemente, puna është që të thithim ajër më të pastër të dyja palët. Ky projektligj që ju keni paraqitur, sa do ta përmirësojë çështjen e ndotjes në Shqipëri?

Mirela Kumbaro- Unë nuk kam pyetje, por do të bëj një koment. Unë mendoj se diskutimi i këtij projektligji në këtë komision duhet të kufizohet në atë që ka të bëjë me ne, sa përputhen dispozitat e këtij projektligji me direktivat e BE-së. Do të ishte mirë që edhe për të ekonomizuar kohën, shumë pyetje që u bënë nga kolegët mund të konsumohen në komisionin përkatës, ku do të sqarohen e do të miratohen ose jo. Kështu që, nëse ne kemi ndonjë çështje që mendojmë se në atë komision nuk diskutohet, mund t'ia përcjellim në komisionin. Prandaj, të përqendrohemi te çështjet e përputhshmërisë.

Rudina Hajdari- Faleminderit, zonja Kumbaro!

Mendoj se ishte një ndërhyrje me vend. Ne jemi komision për dhënie mendimi, megjithatë të gjitha shqetësimet që ju ngritët do të pasqyrohen në procesverbal.

Senida Mesi – Ne si deputetë të Komisionit të Integritetit mund të marrim pjesë në komisionet e tjera ku ky ligj trajtohet nen për nen dhe mund të adresoni pyetjet tuaja.

Rudina Hajdari – Zoti Papa, me mirëkuptimin tuaj se ju do t'ia adresoni këto pyetje në Komisionin e Veprimtarisë Prodhuese, fjalën e ka zoti Kasneci.

Dedë Kasneci – Faleminderit!

Ky projektligj për ndryshimet klimatike është përafëruar pjesërisht me dy akte të legjislacionit të BE-së në fushën e ndryshimeve klimatike, konkretisht me direktivën 2003/87 të BE-së të datës 13 tetor 2003, gjithashtu, është përafëruar pjesërisht me rregulloren e BE-së 525/2013 të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 21 maj 2013.

Shërbimi ynë e ka analizuar përputhshmërinë e projektligjit, kemi paraqitur disa vërejtje. Për ekonomizim të kohës suaj jemi dakordësuar paraprakisht edhe me përfaqësuesit e qeverisë.

Faleminderit!

Rudina Hajdari – A jeni dakord me projektligjin në parim?

Zoti Gjoni.

Ralf Gjoni- Unë kam një pyetje lidhur me përafrimin me legjislacionin europian: A kemi ne detyrime që burojnë nga direktivat e BE-së sa i përket menaxhimit të nivelit të grimcave PM10 dhe PM5? Tirana, sipas raporteve të OBSH-së, renditet si një nga kryeqytetet më të ndotura në botë, jo vetëm në rajon. Nuk kam pasur mundësi ta shoh të gjithë dokumentacionin, po e kërkoj si informacion për veten, si deputet, dhe çfarë mund të bëjmë si parlament për përmirësimin e gjendjes?

Ornela Çuçi- Grimcat PM5 dhe PM10, nuk janë subjekt i këtij ligji. Subjekt i këtij ligji janë vetëm gazet me efekt serë, të cilat ndikojnë në mënyrë të jashtëzakonshme. Janë vetëm 13 kompani, të cilat do të duhet të raportojnë për efektin serë. Këto janë subjekt i këtij ligji. Nëse ju doni diçka ekstra për shkakimin e pasojave të grimcave PM5 dhe PM10, mund të vijmë një moment tjetër dhe t'ju bëjmë një shpjegim të hapësirës sonë ligjore dhe çfarë do të duhet që të plotësojmë në këtë hapësirë ligjore për shkak të emetimeve në ajër.

Rudina Hajdari –Faleminderit!

Hedhim projektligjin në votim.

Kush është pro? Kundër? Abstenime?

Miratohet.

Kalojmë në votimin nën për nën me rekomandimet që janë propozuar nga zoti Kasneci.

A jeni dakord t'i kalojmë të gjitha nënët së bashku? Dakord.

Kalojmë në votimin në tërësi. Kush është dakord? Kundër? Abstenime?

Dakord.

Faleminderit, zonja Çuçi!

Ornela Çuçi – Të gjitha propozimet që kanë ardhur nga ky komision për shkak të ndryshimit të terminologjisë në disa aspekte të ligjit do të merren parasysh nga ministria jonë për t'u reflektuar.

MBYLLET MBLEDHJA